



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M
Nr. 58, datë 30.9.2017

**PËR DHËNIE PËLQIMI PËR DHËNIE ME QIRA NJË ZYRË SHËRBIMI ME
SIPËRFAQE 12 M², PRONË E BASHKISË SHKODËR NË GODINËN E NJËSISË
ADMINISTRATIVE GUR I ZI**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.9.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 8 pika 2, 9 pika 1/1.2, 54 shkronja “e”, 55 pika 4 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar, me 31 vota pro,

V E N D O S I :

1. Të japë pëlqimin për dhënien me qira të një zyre shërbimi me sipërfaqe 12 m² pjesë e pasurisë së paluajtshme nr. 218, në zonën kadastrale 1898, në njësinë administrative Guri i Zi, Bashkia Shkodër, sipas plan rilevimit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratur në datën 30.9.2017

Shpallur në datën 2.10.2017

Sekretar i këshillit

Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU SHKODËR
PREFEKTI

Prot 15538

01.17.10.17

Nr. 1029/1Prot

Shkodër, me 16.10.2017

Lënda: Mbi vendimin nr. 58, datë 30.09.2017 të Këshillit Bashkiak Shkodër.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016, dt 2.10.2016 "Për Prefektin", shqyrtoi vendimin nr.58, datë 30.09.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër "Për dhënie pëlqimi (*dhenie ne perdorim, terminologji e sakte sipas nenit 54,germa e*) per dhenien me qera nje zyre sherbimi me sipërfaqe 12 m²,prone e Bashkise Shkoder ne godinen e Njesise Administrative Guri i Zi" .

Pas shqyrtimit, Prefekti ne mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.2, germa a,nenit 36, nenit 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 4, të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr.115/2014 datë 31.07.2014 për "Ndarjen Administrativo-Territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), Ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për Pronat e paluajtshme të shtetit" (i ndryshuar),VKM Nr.54 dt.5.02.2014¹ "Per percaktimin e kriterëve te procedures e te menyres se dhenies me qera,enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", neni 56 KPA, ju autorizohet te procedoni.

Me respekt



¹ Tërheqje vëmendje për mospercaktim edhe të këtij akti normativ